



## FTESË PER OFERTË

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe në nevojë, pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë duke përfshirë të gjithë projektet në kuadër të organizaës, fton kompanitë e specializuara dhe të interesuara: **për Përkthim të Materialeve Zyrtare, përkthim simultan dhe përkthim konsektiv**

**Me këtë rast ju bëjmë Ftesë për ofertë sipas specifikacionit në vijim:**

### LOT 1

- Përkthim i materialeve zyrtare te shkruara nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas
- Përkthim i materialeve zyrtare te shkruara nga gjuha shqipe në gjuhen angleze dhe anasjelltas
- Përkthim i materialeve zyrtare te shkruara nga gjuha serbe në gjuhen angleze dhe anasjelltas

### LOT 2

- Përkthim simultan nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas,
- Përkthim simultan nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas
- Përkthim simultan nga gjuha serbe në gjuhën angleze dhe anasjelltas
- Përkthim konsektiv nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas
- Përkthim konsektiv nga gjuha shqipe në gjuhen angleze dhe anasjelltas
- Përkthim konsektiv nga gjuha sserbe në gjuhen angleze dhe anasjelltas
- Pajisjet për përkthim simultan

### Ofertuesit e interesuar për LOT 1 së bashku me ofertën duhet të dorëzojnë

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit /NUI
- Oferta financiare duhet të përmbajë:
  - Çmimin për faqe
  - Çmimin për fjalë
  - Çmimet të kuotohen (të ceken) në euro pa tvsh
  - Oferta të jetë e vulosur dhe nënshkruar apo me logo zyrtare
    - Së paku tre letër referenca të kompanisë/ dokument dëshmie për përvojën e punës
    - Së paku tre CV/ Resume të përkthyesve që do të angazhohen sipas gjuhëve të kërkuara më lartë
    - Përkthyesit duhet të kenë së paku 3 vjet përvojë pune në fushën e përkthimeve
    - Së paku **nga një** dokument/ publikime të përkthyer **për secilën** nga gjuhët e kërkuara më lartë në fushën sociale dhe fusha të ngjashme.

### Ofertuesit e interesuar për LOT 2 së bashku me ofertën duhet të dorëzojnë:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit /NUI
- Oferta financiare duhet të përmbajë:
  - Çmimet e kuotuar në euro pa tvsh
  - Oferta të jetë e vulosur dhe nënshkruar apo me logo zyrtare
- Oferta për përkthim simultan duhet të përmbajë çmimin për gjysëm dite pune si dhe çmimin për ditë të plotë pune për përkthime simultane gjatë trajnimeve dhe grupeve punuese bashkë me pajisjet për përkthim simultan
- Oferta për përkthim konsektiv duhet të përmbajë çmimin për gjysëm dite pune si dhe çmimin për ditë të plotë pune për përkthime konsektive gjatë trajnimeve dhe grupeve punuese
  - Së paku tre letër referenca të kompanisë / dokument dëshmie për përvojën e punës
  - Së paku tre CV/Resume të përkthyesve që do të angazhohen sipas gjuhëve të kërkuara më lartë
  - Përkthyesit duhet të kenë së paku 3 vjet përvojë pune në fushën e përkthimeve
- Ofertën për pajisjet për përkthim simultan (për së paku 25 persona) me:
  - Kufje (pa tela)
  - Mikrofon (pa tela)
  - Zërim

### **Kriteret e përzgjedhjes për LOT 1: Ofertat do të vlerësohen bazuar në kriteret e mëposhtme të vlerësimit**

Kriteret e Vlerësimit- Gjithsej 100 pikë

- Së paku tre letër referenca të kompanisë / dokument dëshmie për përvojën e punës
- Së paku tre CV/Resume të përkthyesve që do të angazhohen sipas gjuhëve të kërkuara më lartë
- Përkthyesit duhet të kenë se paku 3 vjet përvojë pune në fushën e përkthimeve
- Së paku nga një dokument/ publikime të përkthyer për secilën nga gjuhët e kërkuara më lartë në fushën sociale dhe fusha të ngjashme.  
(60 Pikë)
- Oferta Financiare: (40 Pikë)

### **Kriteret e përzgjedhjes për LOT 2: Ofertat do të vlerësohen bazuar në kriteret e mëposhtme të vlerësimit**

Kriteret e Vlerësimit- Gjithsej 100 pikë

- Së paku tre letër referenca të kompanisë / dokument dëshmie për përvojën e punës
- Së paku tre CV/Resume të përkthyesve që do të angazhohen sipas gjuhëve të kërkuara më lartë
- Përkthyesit duhet të kenë së paku 3 vjet përvojë pune në fushën e përkthimeve
- Paisjet për përkthim simultan (për së paku 25 persona) me:
  - Kufje (pa tela)
  - Mikrofon (pa tela)
  - Zërim  
(60 Pikë)
- Oferta Financiare: (40 Pikë)

*Me rastin e nënshkrimit të kontratës ofertuesi i përzgjedhur duhet të dorëzojë dëshmi se personi përgjegjës dhe pronari i biznesit nuk janë nën hetime për vepra penale si dhe Vertetimin Tatimor*

### **Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë 30 ditë nga data e mbylljes së Ftesës për Ofertë**

Ju mund të ofertoni për një LOT ose për të dy LOT- et, duke i dërguar ofertat ndarazi të emëruar Lot 1 ose Lot 2 sipas Lot-it përkatës

Ofertat duhen të jenë (1 në origjinale + 1 kopje) në pliko të mbyllur, të specifikuara për: **“Oferta për Shërbime Përkthimi”** dhe të dorëzohen në SOS-Fshatrat e Fëmijëve Rr. 1 Tetori p.n.

Velani cdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri më **05.09.2023**